



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.12, datë 16.02.2024

PËR

**“SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE PËR DREJTUESIT E PROKURORIVE
PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM, NËPËRMJET PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 52 pika 5, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të shpallë fillimin e procedurës për plotësimin e vendeve vakante për drejtues si më poshtë:
 - Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
 - Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;
 - Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.
2. Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë, kriteret që duhet të plotësojnë, afati i dorëzimit të shprehjes së interesit, dokumentacioni që duhet të dorëzojnë dhe adresa ku do të dorëzohet shprehja e interesit, do të njoftohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më datë 16.02.2024.

KRYETAR

Alfred Balla

